

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“GLAMOUR PELLETS ALBANIA” Sh.p.k

Unë Ardian Xhangoli, i biri i Laverit -it ,i datëlindjes 12.02.1990 shtetas Shqiptar , me numer personal ID:J002121180, banues ne Gramsh

Unë Vaskë Xherahu, i biri Sotiraqit -s ,i datëlindjes 13.04.1980, Shtetas Shqiptar me numer personal ID:I00413205W banues ne Korce

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 17.04.2024 krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “GLAMOUR PELLETS ALBANIA ”, me aktin themelues të saj si vijon :

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “GLAMOUR PELLETS ALBANIA” Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private “GLAMOUR PELLETS ALBANIA”. do të jetë :
Njesia bashkiake Nr 7, Rruga “Vangjush Furxhi”, Pll nr 5, shk nr 4, ap nr 3, Tirane. Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

Tregeti me shumice dhe pakice të peletit dhe produkteve të drurit Import – eksport. Grumbullimi, menaxhimi dhe përpunimi i mbetjeve të drurit.. Në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të lëndës drusore, prodhimit të produkteve dhe gjysëmfabrikave në dru, dyer, dritare, parket, mobilje dhe produktet e tyre me shumicë dhe pakicë. Importe-Eksport te nenprodukteve te drurit ,pelet,tallash etj.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.



KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private “GLAMOUR PELLETS ALBANIA” do të jetë 500,000 Leke (Peseqind mije) leke. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Kapitali përbëhet nga 2 kuota

Z. Ardian Xhangoli zotëron 1 kuote me vlere 250,000 Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar

Z. Vaskë Xherahu zotëron 1 kuote me vlere 250.000 Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar



Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z Ardian Xhangoli i cili është edhe përfaqësuesi ligjor i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhe kohore prej 5 vjet , nga dat 17.04.2024 deri ne daten 16.04.2029

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakeve themelues të shoqërisë, Ardian Xhangolli 50/100, dhe Vaskë Xherahu 50/100

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare “GLAMOUR PELLETS ALBANIA ”


Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“GLAMOUR PELLETS ALBANIA”

Ardian Xhangoli

Vaskë Xherahu

Ardian Xhangoli 

Vaskë Xherahu 